REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA
KUVENDI I KOMUNËS NË SUHAREKË
MUNICIPAL ASSEMBLY- SUHAREKË
SKUPSTINA OPSTINE SUVA REKA

Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d), lidhur me nenin 17, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008", e në mbështetje të dispoziatve të Ligjit Nr.2004/21 për veterinarinë "Gazeta zyrtare Nr.18/2007" i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-091, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2022" dhe Udhëzimin administrativ (MBPZHR) -Nr.12/2025 për vlerësimin dhe kompensimin e kafshëve të asgjësuara për shkak të sëmundjeve infektive, e në zbatim të kërkesës të Agjencionit për ushqim dhe veterinarinë, me numer te protokollit 01-Nr-181-46003 të datës 04.09.2026 dhe konform nenit 15, lidhur me nenin 29, pika 2 të Statutit të Komunës së Suharekës, 01-Nr-8336, i datës 04.11.2008, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, 25.09.2026, miratoi këtë:

V E N D I M

Neni 1

1. Me këtë vendim caktohet lokacioni për groposjen–varrimin e kafshëve të cilat konstatohen se janë me sëmundje infektive, në pjesën e parcelës kadastrale **P-721160436-00043-2,** me sipërfaqe të përgjithshme prej; **46549m²,** sipas certifikatës së pronës **nr.11-463-1352/2026,** datës 08.09.2026, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura **"Biraç"** e evidentuar pasuri shoqërore ndërrmarrja e pyjevë biraq, shfrytëzues për kohë të pacaktuar në emër Komuna e Suharekës.

2. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës të cekur në piken 1, të nenit 1, të këtij vendim, ndahen **1000m²** për groposjen –varrimin e kafshëve të cilat konstatohen se janë me sëmundje infektive nga Agjencioni për ushqim dhe veterinarinë,.lokacioni caktohet vetëm për Komunën e Suharekës.

Neni 2

Pas mbushjes së lokacionit i cili është i caktuar për groposjen –varrimin e kafshëve të cilat konstatohen se janë me sëmundje infektive, Komuna është e obliguar që lokacionin apo parcelën e cekur më lart ta ri-kultivon në atë mënyrë që të jetë e përshtatshme për shfrytëzim pa pengesa.

Neni 3

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për shërbime pronësore-juridike dhe kadastër, Drejtoria për inspeksion e Komunës së Suharekës dhe Agjencioni per ushqim dhe veterinarinë.

Neni 4

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 30, ditë pas dërgimit në organin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 8, lidhur me neni 9, të Ligjit Nr. 08/L-284, për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, publikuar në "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 24/2024" dhe nenit 8, lidhur me nenin 9, të Rregullores, (QRK) Nr. 03/2026, për procedurat e shqyrtimit administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose faqen zyrtare të Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS- SUHAREKË

01-Nr-016-48880
Më datë 25.09.2026

Kryesuesi i Kuvendit

Mr.ec Bexhet KUÇI